



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Study program **Menaxhimi bashkëkohor bankar**

Fakulteti	Biznesi dhe Ekonomia
Cikli i studimeve	Cikli i parë (Deridiplomike)
SETK	180
Numri në arkiv i akreditimit [180]	03-160/2
Vendimi për fillim me punë	17-1389 (20.05.2016)
Data akreditimit	31.03.2015

Përshkrimi i programit

Kurikulumi "Menaxhimi bashkëkohor bankar" është një kombinim i balancuar i njohurive primare teorike specifike dhe i aftësive profesionale. Struktura e programit trevjeçar përfshin studime që janë nga natyra dinamike, integruese dhe interaktive. Programi është dizajnuar për të ofruar qasje e tema integruese të menaxhimit modern të bankës, duke zbatuar këtë koncept me anë të mësimin dhe programit praktik. Gjërat e përfshira në këtë program paraqesin perspektivat që bazohen në teorinë, e cila është e lidhur ngushtë me zbatimin praktik në botën e biznesit. Ky program u mundëson studentëve t'i fitojnë aftësitë dhe përvojën e nevojshme për punë bankare, përdorimin e menaxhimit, marketingut dhe të financës në operacionet bankare.

Gjatë programit trevjeçar studentët kanë mundësi për punë praktike në mënyrë që të aplikojnë njohuritë dhe aftësitë e fituara në këtë fushë. Puna praktike përfshihet në tërë ciklin e studimeve dhe është e detyrueshme. Rreth 50% të kohës së tyre studentët do të kryejnë punë praktike në kompani të specializuara për menaxhimin bashkëkohor bankar, njëkohësisht do të avancojnë njohuritë dhe shkathtësitë e tyre praktike në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe në mënyrë specifike për të përmbushur kërkesat e bankave.

Karriera

Programi studimor *menaxhimi bashkëkohor bankar* synon:

- t'i përgatisë studentët për pozitën e udhëheqësit në organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse në vend dhe në botë.
- t'i përgatisë studentët për të ndërtuar karrierën në fushën e menaxhimit bankar, por edhe në sektorin privat në fushën e financave.
- të mundësojë përvetësimin e aftësive hulumtuese dhe të përvojës në çështjet bankare, përdorimin e menaxhimit, marketingut dhe financës në operacionet bankare.
- ta zhvillojë konceptin e punës praktike të studentëve.
- ta zhvillojë konceptin e të menduarit kritik të studentëve.
- të mundësojë që studentët në mënyrë aktive të marrin pjesë në ligjërata dhe punë praktike, që në mënyrë të pavarur të bëjnë kërkime në të gjitha fushat e administrimit të biznesit.
- ta mundësojë zhvillimin e aftësive personale, të komunikimit, hulumtimit dhe aftësive të tjera të rëndësishme të nevojshme për punësim.

Rezultatet e të mësuarit

Njohuritë dhe të kuptuarit

- Ka njohuritë e nevojshme për funksionet e mëposhtme: të marketingut, ekonomisë, menaxhimit, të financave, të modelimit të biznesit, të operacioneve të menaxhimit, të menaxhimit të riskut, të udhëheqjes sipërmarrëse, menaxhimit strategjik, të bazave të së drejtës biznesore dhe të planifikimit të biznesit.
- Ka njohuri të zonave funksionale të kërkimit, sipërmarrjes dhe inovacionit të vazhdueshëm, për tendencat e ardhshme dhe ndikimin e këtyre zhvillimeve në teori dhe praktikë.
- Ka një njohuri dhe të kuptuarit e situatës kombëtare, rajonale dhe globale ekonomike në treg.
- Ka njohuri të teorive financiare, për analiza dhe raportim.
- Fiton një themel të fortë diturie për fillimin e një biznesi dhe është i gatshëm për karrierë për studime pasuniversitare në lidhje me menaxhimin e ndërmarrjeve, sipërmarrjeve ose për fusha të ngjashme.
- Të kuptuarit e mjeteve të ndryshme për marrjen e vendimeve menaxheriale.

Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit

- Aftësi për të shkruar profesionalisht dhe të zhvillojnë më tej planin e tyre të biznesit dhe zbatimin e tij në jetën reale.
- Aftësi për të zbatuar parimet e nevojshme në procesin e menaxhimit me sukses të sipërmarrjes së re.
- Aftësi për të ndihmuar në formulimin dhe zbatimin praktik të planeve dhe strategjive të suksesshme të menaxhimit, marketingut, financiar.

Aftësitë për të vlerësuar

- Të mendojnë në mënyrë kritike dhe t'i aplikojnë njohuritë teorike dhe praktike dhe përvojën për të identifikuar dhe për të analizuar biznesin problematik
- Të analizojnë dhe të vlerësojnë në mënyrë kritike mundësitë e identifikuara sipërmarrëse.
- Të menduarit strategjik dhe arsyetimi në lidhje me aktivitetet që lidhen me zhvillimin, krijimin dhe mirëmbajtjen e një modeli të përshtatshëm të biznesit.

Aftësitë e komunikimit

- Kuptojnë dinamikën individuale dhe grupore në organizata.
- Veprojnë në mënyrë efektive në punën në grup.
- Menaxhimi efektiv me njerëz me prejardhje të ndryshme sociale, ekonomike, kulturore dhe fetare.
- Demonstrojnë kuptim dhe ndjeshmëri ndaj përgjegjësisë etike, sociale dhe ligjore të kompanive.
- Tregojnë idetë e biznesit në mënyrë efektive.
- Demonstrojnë aftësitë negociuese kryesore.
- Interpretojnë të dhënat e biznesit dhe treguesit ekonomike.

Aftësitë e të mësuarit

- Mund të hulumtojnë dhe të zbulojnë burimet e të mësuarit;
- Mund të aftësohen për mësim individual dhe ekipor;
- Kanë aftësinë për të bërë analizën e biznesit dhe përdorimin e literaturës shkencore, si dhe analiza të opinionëve dhe të vlerësimeve të autorëve të tjerë.

Lista e lëndëve

Semestri 1

- Hyrje në konceptet e biznesit
- Praktikë
- Mikroekonomia dhe çmimet
- Konceptet e marketingut dhe komercializimin
- Lëndë zgjedhore 1
- Lëndë zgjedhore e lirë 1

Semestri 2

- Praktikë

- Makroekonomia
- Hyrje në sistemin bankar
- Matematika e biznesit
- Lëndë zgjedhore 2
- Lëndë zgjedhore e lirë 2

Semestri 3

- Planifikimi dhe analiza financiare
- Praktikë
- Financat e korporatës
- Menaxhimi i riskut në sistemin bankar
- Lëndë zgjedhore 3
- Lëndë zgjedhore e lirë 3

Semestri 4

- Praktikë
- Paratë dhe bankat
- Marketingu bankar
- Menaxhimi i burimeve njerëzore
- Lëndë zgjedhore 4
- Lëndë zgjedhore 5

Semestri 5

- Mbikëqyrja bankare
- Menaxhimi i projekteve
- Metodat e vlerësimit të mjeteve dhe pronës
- Praktikë
- Lëndë zgjedhore 6
- Lëndë zgjedhore 7

Semestri 6

- Praktikë
- Strategji për menaxherët
- Menaxhimi bankar
- Aftësitë profesionale të menaxhimit
- Lëndë zgjedhore 9
- Lëndë zgjedhore 8

Description of courses

Lëndë obligative

- **Hyrje në konceptet e biznesit**

Qëllimi i lëndës është që studentët të kenë njohuri për mjedisin e jashtëm dhe të brendshëm të kompanisë. Megjithatë, vëmendje do t'i kushtohet funksionit financiar, marketingut, menaxhimit dhe organizimit të ndërmarrjes. Përveç kësaj, do trajtohet ndikimi i perceptuar i kompanisë në bashkësinë në të cilën vepron. Studentët do të fitojnë njohuri që: - t'i shpjegojnë problemet themelore ekonomike; - ta kuptojnë lidhjen midis burimeve të kufizuara, vlerës, përfitimeve dhe pasurisë; - ta kuptojnë lidhjen e kohezionit mes mikro dhe makro ekonomisë; - t'i diskutojnë objektivat dhe instrumentet e makroekonomisë; - t'i kuptojnë dhe t'i shpjegojnë ciklet ekonomike; - të mësojnë të debatojnë për marrëdhëniet ekonomike ndërkombëtare etj.

- Praktikë

- Mikroekonomia dhe çmimet

Lënda është e dizajnuar për t'u dhënë një kuptim themelor për fenomenet ekonomike dhe për terminologjinë globale universale mikroekonomike. I ndjek dhe i analizon qasjet teorike që mundësojnë të kihet qasje në pasqyrën vetanake të zgjidhjeve të mundshme aplikative për problemet e prodhimit, për këmbimin dhe organizimin e ndërmarrjes individuale, për një degë të veçantë apo një treg të veçantë. Komponentët zhvillimorë japin një dimensionin dinamik pa të cilin qasjet e thjeshtësuara do të ishin të papërdorshme. Bazat e mikroekonomisë mësohen në mbarë botën, si pjesë e përpjekjeve universale të identifikohen dhe të përkufizohen problemet e ngjashme dhe të krijohet mundësia që ato të mund të zgjidhen në një mënyrë të ngjashme kudo në botë, por edhe të merret informacioni që të mundet në nivel agregat për të ndihmuar në formulimin e objektivave makroekonomike dhe të elementeve të planifikimit strategjik. Ajo është pjesë e nevojës për të ndërtuar një shoqëri të ngjashme në nivel global, në të cilën kontaktet e shpeshta të biznesit, ato politike, të punës apo të tjera do të jenë të njohshme për të gjithë pjesëmarrësit në të njëjtën mënyrë dhe do të zgjidhen me përdorimin e instrumenteve plotësuese të ngjashme dhe të përdorshme kudo. Bëhen përpjekje për të krijuar mundësi për të përdorur literaturë universale, por edhe sa ka mundësi dhe sa më efektshëm të përdoren komunikimet dhe on-line format e komunikimit.

- **Konceptet e marketingut dhe komercializimit**

Qëllimi i lëndës është që studentët të fitojnë njohuri për konceptet themelore të marketingut në organizatat moderne. Theksi është në konceptet dhe çështjet që lidhen me marketingun e produkteve të konsumit dhe të shërbimeve. Më konkretisht, objektivi është që studentët të fitojnë një kuptim të mjedisit të marketingut duke analizuar në treg, dhe pastaj të zbatojnë strategjitë e suksesshme të marketingut në një mjedis të tillë. Studentët gjithashtu do të jenë në gjendje të zbatojnë konceptet shkencore për të hartuar një plan të plotë të marketingut për produktin e tyre. Ky kurs kontribuon që studentët të familjarizohen me aktivitete të ndryshme në fushën e marketingut, të cilat janë të rëndësishme për kompaninë në mënyrë që të jetë më konkurruese dhe e suksesshme në treg.

- **Praktikë**

- **Makroekonomia**

Qëllimi i lëndës është që studentët të fitojnë njohuri për: - termet dhe kategoritë makroekonomike që janë parakusht për funksionimin e një ekonomie nacionale e cila është pjesë e një sistemi të zgjeruar ekonomik global; - rëndësinë e indikatorëve kryesorë makroekonomikë siç janë: bruto prodhimi kombëtar, të ardhurat kombëtare, rritja ekonomike, ciklet ekonomike, investimet dhe harxhimet publike, inflacioni, papunësia, paratë dhe bankat, buxheti, bilanci i pagesave etj.; - instrumentet themelore të analizës makroekonomike (oferta dhe kërkesa agregate) dhe politikat makroekonomike (politika monetare dhe fiskale) etj.; - funksionimin efikas i një ekonomie kombëtare, krahasuar me ekonominë bashkëkohore të tregut, duke evidentuar në atë drejtim dallimet, ngjashmëritë dhe mundësitë për zhvillimin e ardhshëm të ekonomisë përkatëse. - fushat e makroekonomisë, që do të mundësojë qasje më të lehtë në lëndët tjera të avancuara makroekonomike.

- **Hyrje në sistemin bankar**

Lënda jep njohuri themelore për menaxhimin bankar dhe për politikat rregullative të sistemit financiar modern në botë, si dhe në Maqedoni, për ndërmjetësit kryesorë dhe për funksionet e tyre, si dhe për rolin e bankave në sektorin financiar në Maqedoni. Studentët do të pajisen me njohuri se si funksionon industria financiare dhe cilët faktorë ekonomikë janë më të rëndësishëm për suksesin e menaxhimit të sektorit financiar në botën e sotme financiare.

- **Matematika e biznesit**

Qëllimi i këtij kursi është studentët të aftësohen për sa vijon: - ta aplikojnë sistemin e ekuacioneve lineare për zgjidhjen e problemeve të ndryshme në fushën e biznesit dhe ekonomisë; - t'i aplikojnë njohuritë e tyre për modelet lineare dhe për vargjet e shumta për të zgjidhur probleme të ndryshme në biznes dhe ekonomi; - të fitojnë njohuri të avancuara për llogaritjen e normës së interesit, për depozitat periodike, qiratë periodike, kreditë dhe për vendimmarrjen financiare.

- **Planifikimi dhe analiza financiare**

Qëllimi i kursit është bartja e fondit të nevojshëm teorik të njohurive dhe të shkathtësive të studentëve nga fusha e menaxhimit financiar dhe trajnimi i studentëve me njohuri bashkëkohore teorike dhe praktike dhe pajisja, e përvoja për analizat e koncepteve fundamentale të financave të kompanive, të projekteve financiare dhe reale për investime dhe për vlerësimin e tyre përmes dimensionit kohor të parasë. Qëllimi i lëndës vazhdon me trajnimin e studentëve se si të përdorin burimet adekuate të financimit, menaxhimin efikas të kapitalit dhe përcaktimin e strukturës së duhur, përcaktimin e politikës adekuate të shpërndarjes së fitimit - politikës së dividendit dhe finalizohet me planifikimin financiar dhe parashikimin, etj. Realizimi i objektivave të synuara të lëndës, studentëve u krijon mundësi të reja për

qasje konkurruese në tregun e punës ose menaxhim më efikas të bizneseve të tyre reale.

- **Praktikë**

- **Financat e korporatës**

Qëllimi i lëndës është transferimi i shkathtësive dhe njohurive të nevojshme teorike në fushën e menaxhimit financiar, si dhe përgatitja e studentëve me njohuri dhe me përvojë bashkëkohore teorike në analizën e koncepteve themelore të financave korporative, projekteve investuese financiare e reale dhe vlerësimi i tyre përmes dimensionit kohor të parave. Qëllimi i lëndës vazhdon me trajnimin e studentët se si të përdorin burime adekuate të financimit, si ta bëjnë menaxhimin efikas të kapitalit dhe si ta bëjnë përcaktimin e strukturës adekuate, përcaktimin e politikës adekuate të shpërndarjes së fitimit - politikës së dividendit dhe si të bëhet finalizimi i planifikimit financiar dhe parashikimi, etj. Arritja e objektivave të synuara të lëndës, studentëve u krijon mundësi të reja për qasje më konkurruese në tregun e punës ose menaxhim më efikas të bizneseve të tyre reale.

- **Menaxhimi i riskut në sistemin bankar**

Lënda ka për qëllim të përfshijë mënyrat me të cilat kryhet kuantifikimi dhe menaxhimi i burimeve të ndryshme të riskut nga ana e korporatave. Kjo vlen veçanërisht për fushën e sektorit financiar dhe kujdes i veçantë u kushtohet kompanive jo-financiare. Në këtë mënyrë lënda mbulon një qasje të gjerë të menaxhimit të riskut në ndërmarrje apo "menaxhimin e integruar të riskut" – qasje e re menaxheriale në drejtimin e riskut. Ndër titujt që përfshihen në këtë lëndë një peshë të veçantë kanë rreziku kreditor, rreziku i tregut dhe rreziku operacional. Lënda, në masë të madhe mbështetet në zbatimin aktiv të analizave të rasteve aktuale.

- **Praktikë**

- **Paratë dhe bankat**

Lënda synon të sigurojë njohuri themelore për njërën prej kategorive më dinamike në ekonomi – bankarinë dhe paratë, si një kusht pa të cilin nuk mund të imagjinohet asnjë ekonomi moderne kombëtare. Ta paraqesë dhe ta përshkruajë trajektoren historike të lëvizjes së zhvillimit të sistemit bankar, t'i afrojë përvojat e vendeve të tjera të zhvilluara të botës dhe t'i paraqesë sistemet e vendeve fqinje, si pjesë e rrethimit afërt i cili pas diplomimit do të jetë pjesë e mjedisit të tyre të punës. Të kuptuarit e operacioneve bankare mundëson fitimin më të lehtë të besimit në mesin e bankierëve, kur paraqitet nevoja për monitorimin e kreditor ose ndonjë lloj tjetër të mbikëqyrjes bankare, ose jep mundësi për tërheqje të vëmendjes, ose të fitohet besimi i konsumatorëve që kompania është pjesë e procesit të punës ku ekonomisti i ardhshëm do të punojë. Nga ana tjetër bankaria është profesion tërheqës dhe prestigjioz që nuk është vetëm interesant, por ofron një status të mirë në shoqëri dhe të ardhura të mira.

- **Marketingu bankar**

Qëllimi i lëndës është që studentët të fitojnë njohuri për konceptet themelore që janë të përfshirë në funksionet e marketingut të bankave moderne. Theksi është vënë në konceptet dhe çështjet që lidhen me marketingun e produkteve të konsumit dhe shërbimeve në sektorin bankar. Më konkretisht, objektivi është që studentët të fitojnë një kuptim të mjedisit të marketingut përmes analizës së tregut që pastaj të zbatojnë strategjitë e suksesshme të marketingut në një mjedis të tillë. Studentët gjithashtu do të jenë në gjendje të zbatojnë konceptet shkencore për të hartuar një plan të plotë të marketingut në sektorin bankar. Lënda kontribuon që studentët të familjarizohen me aktivitete të ndryshme në fushën e marketingut bankar, të cilat ndihmojnë që kompania të jetë më konkurruese dhe më e suksesshme në treg.

- **Menaxhimi i burimeve njerëzore**

Qëllimi i lëndës është njoftimi i studentëve me rëndësinë dhe rolin e menaxhimit të burimeve njerëzore në organizatat e biznesit bashkëkohor. Në kuadër të kësaj lënde studentët do të njihen me procesin e menaxhimit të burimeve njerëzore si në teorinë ashtu edhe në praktikën e kompanive ndërkombëtare dhe vendore.

- **Mbikëqyrja bankare**

Lënda mundëson vlerësimin e depozitave jo-monetare, respektivisht kategoritë e ndryshme të mjeteve prej të cilave mund të përbëhen depozitat jo-monetare, pastaj vlerësimin e mjeteve dhe kapitalit në rastet e bashkimit dhe rimarrjes së kompanive, blerjen dhe shitjen e kompanive tregtare dhe vlerësimin gjatë rregullimit të procedurave të falimentimit. Përcaktimi i çmimit të ndershëm të mjeteve dhe të kapitalit është procedure thelbësore që u paraprin shumë operacioneve kontabiliste, financiare, ligjore që lidhen me shitjen, blerjen, marrjen dhe bashkimin e

kompanive. Vlerësimi është baza e çdo shitblerjeje të mjeteve, marrjes dhe konvertimit të detyrave në kapital, shitjet e arkëtueshme, huadhënia dhe operacione të tjera kontabiliste, financiare dhe ligjore.

- **Menaxhimi i projekteve**

Me përfundimin e suksesshëm të lëndës, studentët do të jenë në gjendje: * Të planifikojnë aktivitetet e nevojshme për zbatimin e projektit, të identifikojnë ndërvarësitë e tyre, kohëzgjatjen si dhe kostot e tyre; * Të përgatisin raportet e nevojshme dhe të kryejnë të gjitha komunikimet e nevojshme ndërmjet projektit dhe klientit, si dhe në mes të anëtarëve të ekipit dhe të aktorëve të tjerë; * Të strukturojnë projektin dhe aktivitetet e tij përbërëse; * Të përgatisin një Gantt-tabelë dhe një plan të rrjetit për projektin dhe të identifikojnë kohën më të shkurtër të nevojshme për të përfunduar projektin; * Të përdorin MS Project si një mjet në procesin e planifikimit, zbatimit dhe rishikimit të projektit; * Të përcaktojnë projektin, të identifikojnë lëminë dhe objektivat e tij, si dhe të zhvillojnë specifikat e projektit;

- **Metodat e vlerësimit të mjeteve dhe pronës**

Lënda mundëson një vlerësim të depozitave jo-monetare, respektivisht kategori të ndryshme të mjeteve nga të cilat mund të përbëhen jo-kesh depozitat, pastaj vlerësimin e mjeteve dhe kapitalit në rastet e bashkimeve dhe blerjeve të kompanive, bashkimin e kompanive, shitblerjen e shoqatave tregtare dhe rregulloren e procedurave të falimentimit. Përcaktimi i vlerës së drejtë të tregut të fondeve dhe procedurat e kapitalit themelor u paraprin shumë operacioneve kontabiliste, financiare, ligjore, lidhur me shitjen, blerjen, marrjen e bashkimin e shoqërive. Vlerësimi është themeli i çdo shitjeje të mjeteve, shkarkimit dhe konvertimit të detyrimeve në kapital, shitjet e arkëtueshme duke u zotuar, huadhëniet dhe kontabiliste, financiare dhe veprimet të tjera ligjore.

- **Praktikë**

- **Praktikë**

- **Strategji për menaxherët**

Qëllimi i lëndës është që t'u mundësojë studentëve t'i vlerësojnë dhe t'i aplikojnë elementet kryesore të analizave strategjike, zgjedhjen e strategjisë së duhur në kuadër të planit fleksibil dhe ta nxisë të menduarit për problemet që lidhen me zbatimin e strategjisë së formuluar. Gjithashtu nëpërmjet kësaj lënde, studentët do të fitojnë përvojë në të menduarit kritik në lidhje me çështjet dhe problemet që lidhen me zgjedhjen e strategjisë në mjedisin turbulent dhe dinamik dhe do të kuptojnë se nuk ka një mënyrë të vetme - të drejtë të zhvillohet një strategji. Pas përfundimit të lëndës, studentët duhet të jenë në gjendje: - t'i kuptojnë teoritë dhe konceptet e menaxhimit strategjik; - ta zotërojnë fjalorin përkatës të menaxhimit strategjik; - t'i integrojnë njohuritë e marra nga menaxhmentet e veçanta funksionale; - t'i zhvillojnë aftësitë analitike dhe të komunikimit dhe aftësitë e punës ekipore.

- **Menaxhimi bankar**

Lënda fokusohet në marrjen e vendimeve në menaxhimin e bankës në mjedisin e sotëm operativ dhe në diskutimin për sfidat bashkëkohore të sektorit financiar në botë. Në këtë lëndë do të analizohen faktorët që ndikojnë në kreditë, fondet, investimet dhe vendimet që lidhen me çmimet. Po ashtu do të analizohen dhe gjërat në mes të rrezikut dhe të kthimit për produkte të ndryshme bankare. Lënda gjithashtu do të analizojë bankat kombëtare në Maqedoni dhe në Shqipëri, por dhe bankat qendrore të botës, politikat monetare dhe mbikëqyrjen.

- **Aftësitë profesionale të menaxhimit**

Qëllimi i lëndës është që studentëve t'u ofrojë njohuri për bazat e menaxhmentit, zanafillën dhe definicionin e tij, si dhe parimet themelore në të cilat duhet të bazohet puna e çdo menaxheri të ardhshëm. Kjo lëndë do t'u mundësojë studentëve: - t'i mësojnë bazat e menaxhimit dhe të japin shembuj specifikë; - të jenë në gjendje që studimin e kësaj teme ta shohin si të nevojshme për ta bërë zbatimin praktik në kuadër të mësimin; - për të marrë një mënyrë efektive të të menduarit që do të ndihmojë në trajtimin e problemeve të biznesit të mëtejshëm në jetën e tyre;

Lëndë zgjedhore

- **Menaxhimi i kredisë**

Qëllimi i lëndës është të ofrojë njohuri relevante për qasje moderne ndaj analizave të kredisë së personave juridikë dhe fizikë, për strukturën dhe klasifikimin e kredive bankare, identifikimin e roleve dhe përgjegjësisë të ndryshme të analistëve të kredive, komponentët kryesorë të analizës së kredive me theks mbi rëndësinë e analizës së kredive për

të përcaktuar rrezikun për klientin individual, me standarde dhe qasje të re të analizës ekonomike dhe financiare, duke identifikuar pikat e forta dhe dobësitë e tyre kryesore, bazat e analizave DuPont dhe metodologjitë e tjera të ngjashme të cilat mund të jenë të dobishme në analizën e kredisë, standardet e Baselit për menaxhimin e riskut në industrinë bankare, analizën e aplikacioneve të kredisë, të procesit të kredisë, me qëllim të sjelljes së vendimeve të duhura kreditore.

- **Hyrje në kontabilitet**

Qëllimi i lëndës është t'i ndihmojë studentët të kuptojnë thelbin e kontabilitetit, për të mësuar bazat e kontabilitetit financiar dhe konceptet e parimet e kontabilitetit. Në mënyrë të veçantë, studentët mund të fitojnë njohuri mbi pasqyrat financiare, komponentët e tyre, rregullat themelore të evidentimit të të dhënave të kontabilitetit, përdorimin e dokumenteve të kontabilitetit.

- **Tatimet vendore dhe ndërkombëtare**

Objekti kryesor i lëndës është t'i pajisë studentët me njohuritë bazë në fushën e tatimeve dhe mekanizmat e funksionimit të sistemit tatimor në një ekonomi të tregut në vendin tonë dhe jashtë vendit.

- **Shkrimi dhe analiza e biznes planit**

Qëllimi i lëndës është të paraqitet se si përgatiten dhe si sillen vendimet me plan për objektivat, politikat dhe planet e bazuara në parakushtet për planifikim efektiv dhe cilësor. Mes tyre, vëmendje të veçantë meritojnë: parashikimi, sistemi i informacionit, metodologjia e planifikimit, organizimi, planifikimi, metodat për planifikim dhe menaxhimi i projekteve.

- **Etika menaxheriale dhe menaxhimi me stejkholderë**

Lënda synon të zhvillojë njohuri të përgjithshme teorike rreth përgjegjësisë korporative shoqërore në ekonominë moderne dhe të analizojë reflektimin e përgjegjësisë korporative shoqërore për operacionet e përgjithshme të kompanisë. Lënda fokusohet në mënyrën se si menaxherët mund të zbatojnë strategji efektive që lidhen me qëndrueshmërinë e korporatave dhe përgjegjësi shoqërore korporative.

- **Tregjet dhe institucionet financiare**

Qëllimi i këtij programi është që t'i njoftojë studentët me parimet themelore të funksionimit të tregjeve financiare (tregjet e parasë, tregjet e kapitalit, tregjet e këmbimit valutor, etj.) dhe institucionet financiare (bankat, kompanitë e sigurimeve, fondet pensionale, fondet e investimeve, etj.) të cilat janë pjesë jashtëzakonisht e rëndësishme e çdo ekonomie kombëtare dhe e ekonomisë botërore në tërësi.

- **Analiza e pasqyrave financiare**

Qëllimi i lëndës është që t'u mundësojë studentëve të kryejnë analizë të pasqyrave financiare. Lënda mbulon temat e mëposhtme: bazat e analizave financiare, llojet e analizave financiare, kornizat analitike për analizën e pasqyrave financiare, sistemin e raportimit financiar, bazat e pasqyrave financiare, mjetet dhe fitimet e kontabilitetit, analiza e rrjedhës së parasë, treguesit financiarë dhe analizat financiare, analizat e integruara, analizat e detyrimeve financiare, analizat e raporteve financiare, sintezat dhe analizat e strukturës së kapitalit.

- **Analiza statistikore për menaxherët**

Qëllimi i lëndës është që studentët të fitojnë njohuri: - ta përdorin analizën përshkruese dhe analizën e të dhënave; - t'i përdorin probabilitetin dhe variablat e rastit në zgjidhjen e problemeve të biznesit; - ta kuptojnë përfundimin statistikor që është bazë për interpretimin e rezultateve dhe për marrjen e vendimeve të biznesit; - t'i përdorin korrelacionin dhe regresionin e thjeshtë dhe të shumëfishtë; - t'i dinë bazat e analizës së variancës; - t'i kuptojnë bazat e numrave indeks dhe metodat për analizë të serive kohore.

- **Komunikimi i afarist**

Qëllimi i lëndës është që t'i njoftojë studentët me konceptin e komunikimit afarist. Kohëve të fundit kompanitë gjithnjë e më shumë i aplikojnë teknikat e komunikimit afarist si mjet kryesor për t'iu përgjigjur konkurrencës në tregun global. Kjo lëndë është një përpjekje për të përmirësuar aftësitë e komunikimit të studentëve si në aspektin teorik, ashtu edhe në atë praktik në një mjedis organizativ me punonjësit dhe menaxherët, gjatë mbledhjeve, intervistave; si të përgjigjen gjatë intervistimit, negocimit dhe motivimit të rrethit.

- **Menaxhimi i lojërave**

Lënda synon ta përmirësojë aftësinë strategjike vendimmarrëse të studentëve në situata konkurruese në të cilën vlerësimi i tyre për rezultatin e një veprimi varet jo vetëm nga zgjedhjet që bëjnë ata, por edhe nga zgjedhjet e bëra nga të tjerët. Ne përqendrohemi në një metodë analitike e cila rrjedh nga teoria e lojës dhe e cila ofron një kornizë rigorozë analitike për strukturimin e situatave konkurruese, identifikimin e alternativave, duke zgjedhur mes tyre.

Qasja themelore do të jetë thyerja e kompleksitetit në copa, përdorimi i mjeteve lojëra teorike për të analizuar pjesët dhe pastaj grumbullimi i pjesëve në një kuptim logjik koherent. Qëllimi ynë është që studentët të bëhen krijues më të mirë strategjikë vendimmarrës kur të përballen me sfidat konkurruese. Objektivat tona kryesore do të jenë përdorimi i koncepteve të teorisë së lojës dhe i mjeteve për identifikimin, diagnostifikimin dhe analizimin e sfidave konkurruese me të cilat përballen firmat në industri dinamike dhe zbatojnë konceptet e teorisë së lojës dhe mjetet e zhvillimit të strategjive për përparësinë konkurruese. E gjithë kjo do të bëhet duke analizuar lojëra të ndryshme.

- **Sistemi bankar ndërkombëtar**

Lënda studentëve u mundëson fitimin e njohurive në lidhje me sistemin bankar ndërkombëtar. Po ashtu, lënda u mundëson studentëve të bëjnë dallimin në mes teorisë dhe praktikës në sektorin bankar ndërkombëtar, ta dinë rolin e transaksioneve në sistemin bankar ndërkombëtar, mënyrën e bërjes së tyre. Do të mësohen edhe garancitë bankare dhe letrat e kreditit, EUROLIBO, kodet gjatë ekzekutimit të transaksioneve.

- **Bankieria elektronike (E-Banking)**

Lënda bankiera elektronike ndihmon studentët në zgjidhjen dhe vendosjen e strategjive që fokusohen në çështjet operative dhe menaxheriale dhe që lidhen me E-banking. Për më tepër, studentët do të pajisen me njohuri në lidhje me mundësitë E-banking, strategjitë e reja të çmimeve që bankat duhet të ndjekin, si të sigurohen transaksionet elektronike etj.

- **Analiza e kostos**

Qëllimi i lëndës është që studentët të fitojnë njohuri në fushën e analizës së kostos dhe menaxhimit, i cili përdoret nga menaxherët kur marrin vendime. Në mënyrë të veçantë, lënda i njofton studentët me konceptet e analizës së kostos për nevojat e menaxherëve dhe për mjetet e nevojshme për marrjen e vendimeve menaxheriale.

- **Politika e normave të interesit**

Lënda trajton politikën e normë së interesit përmes analizës sistematike të teorisë monetare dhe sistemit bankar. Studijohen teknikat bashkëkohore të analizës, ndikimi i informacionit mbi strukturën financiare dhe politikën monetare, struktura dhe rëndësia e sistemit financiar, funksionet e parave, sjellja e normave të interesit, struktura financiare dhe informacioni asimetrik, metodat e modelimit për përcaktimin e normës së interesit, përcaktuesit e normës së interesit, si dhe kërkesa dhe oferta e fondeve të kredisë.

- **Standarde ndërkombëtare të kontabilitetit**

Qëllimi i lëndës është që studentët të fitojnë njohuri mbi standardet ndërkombëtare të kontabilitetit. Studentët do t'i mësojnë të gjitha pasqyrat themelore financiare që bazohen në standarde ndërkombëtare. Studentët, gjithashtu, do të jenë në gjendje të bëjnë dallimin në mes standardeve të kontabilitetit vendor dhe standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit.

- **Qeverisja korporative**

Qëllimi i lëndës është që t'i njoftojë studentët me menaxhimin e korporatave dhe të fitojnë njohuri dhe t'i kenë pikëpamjet e tyre kritike rreth stakeholderëve të qeverisjes së korporatave në vendin tonë dhe në botë nëpërmjet një analize krahasuese të praktikave të mira të qeverisjes së korporatave. Mësimi i lëndës qeverisja korporative studentëve do t'u mundësojë: - të fitojnë njohuri të gjera në lidhje me korporatat dhe rëndësinë e tyre për funksionimin e shoqërive bashkëkohore; - të fitojnë njohuri të gjera në lidhje për modelet e qeverisjes korporative që aplikohen në pjesë të ndryshme të botës bashkëkohore; - të fitojnë njohuri dhe të aftësohen të krijojnë pikëpamjet e tyre mbi aktorët kryesorë të qeverisjes së korporatave etj.

- **Të folurit publik**

Pas përfundimit të këtij kursi studentët do të fitojnë njohuri në lidhje me procesin e komunikimit, për përgjegjësitë etike të oratorit publik dhe për modelet e ndryshme të fjalimeve informative dhe bindëse. Përveç kësaj, studentët do të pajisen me shkathtësi të nevojshme për përgatitjen dhe për dorëzimin e llojeve të ndryshme të fjalimeve. Po ashtu ata do të aftësohen ta analizojnë publikun, të gjurmojnë tema për fjalime, të përgatisin fjalime, e të tjera. Pas përfundimit të këtij kursi, studentët do të jenë në gjendje të mendojnë në mënyrë kritike duke qenë vetëkritikë, konstruktivë dhe gjithashtu kritikë ndaj fjalimeve të kolegëve.

- **Studime ndërkulturore**

Pasi të kenë përfunduar kursin, studentët do të mund t'i identifikojnë çështjet dhe problemet globale nga perspektiva e kulturave të ndryshme, dinamikën e komunikimit në kulturat tjera, ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet vlerave të tyre dhe ato të kulturave tjera, si dhe ngjashmëritë dhe dallimet e praktikave të komunikimit të tyre dhe të kulturave tjera. Përveç kësaj, nga studentët pritet që të bëhen më të vetëdijshëm për stereotipet që shoqëria i ka për kulturat e ndryshme dhe si pasojë më mirë do ta kuptojnë vendin e tyre në komunitetin global. Studentët do të fillojnë të

mendojnë në mënyrë kritike për temat rreth etnisë së tyre, për identitetin gjinor, klasën, fenë, origjinën kombëtare, moshën si dhe për karakteristikat tjera demografike dhe ndikimin e tyre në procesin e komunikimit. Pas përfundimit të kursit studime ndërkulturore studentët do të fitojnë shkathtësi të nevojshme komunikimi për punën në grupe përmes pjesëmarrjes së tyre në hulumtime dhe gjithashtu do të fitojnë shkathtësi për t'i prezantuar këto projekte kërkimore.

- **Aftësitë e komunikimit**

Ky kurs është dizajnuar t'u mundësojë studentëve që praktikisht ta zbatojnë komunikimin ndërpersonal. Studentët do të pajisen me shkathtësi ndërpersonale siç janë perceptimi, të dëgjuarit, komunikimi verbal dhe ai jo verbal; do ta ushtrojnë të folurit publik si për shembull: organizimin, prezantimin dhe bazat e të shkruarit fjalime publike. Studentët do të kenë mundësinë të praktikojnë komunikimin në grupe të vogla, (lidhshipi, vetëbesimi dhe të dëgjuarit). Kursi po ashtu ofron njohuri themelore të nevojshme për ta kuptuar procesin e kërkimit të një vendi pune si nëpërmjet komunikimit me shkrim ashtu edhe me komunikim me gojë, përmes detyrave siç janë: shkrimi i biografisë, letër motivimi dhe simulime për intervista.

- **Excel i avancuar**

Qëllimi i këtij kursi është që studentët të fitojnë me njohuri të avancuara për zbatimin dhe mundësitë që i ofron aplikimi i Microsoft Excel-it dhe njëherësh të aftësohen për realizimin e detyrave të avancuara lidhur me programin i cili mësohet në fakultetin e tyre.

- **Aftësi të avancuara të TI-së**

Qëllimet e këtij kursi janë: T'u mundësojë studentëve të fitojnë njohuri themelore dhe të aftësohen në fushën e shkencave informative dhe t'i njoftojë ata me mundësitë që i japin këto shkenca. T'i pajisë studentët me njohuri teorike dhe praktike rreth aplikacioneve të Microsoft Office (Windows, Word, PowerPoint, Excel, Access) dhe t'u mundësojë që këto aplikacione t'i aplikojnë edhe në jetën e përditshme. T'u mundësojë studentëve të bëjnë projekte praktike individuale ose në grupe.

- **Word-i i avancuar**

Qëllimi i këtij kursi është t'i pajisë studentët me aftësi të avancuara rreth përdorimit të Word-it. Gjithashtu, u mundëson studentëve që në mënyrë të pavarur të zbatojnë projekte të ndryshme dhe detyra të veçanta komplekse të cilat lidhen me programin e studimeve të tyre.

- **Google Apps**

Qëllimet e këtij kursi janë: T'u mundësojë studentëve të fitojnë njohuri dhe aftësi të avancuara në fushën e shërbimeve elektronike (cloud applications). T'u mundësojë studentëve të fitojnë njohuri teorike dhe praktike rreth GoogleDocs (G-mail, dokumente, spreadsheets, prezantime, vizatime dhe formulare) dhe t'i aplikojnë ato në jetën e tyre. T'u mundësojë studentëve të punojnë individualisht ose në grupe në projekte të ndryshme drejtpërdrejt nga web browser-i.

- **Access-i i avancuar**

Bazat e të dhënave (databases) janë mjete ideale për ndjekjen e vëllimeve të mëdha. Microsoft Access-i është një mjet mjaft i fuqishëm dhe i popullarizuar i cili përdoret për hartimin dhe zhvillimin e Windows-based databases. Ky kurs është i dizajnuar për përdorues të rinj të Access-it ku janë të përpunuara funksionet e nevojshme për të punuar me databases.

- **Desktop publikimi**

Qëllimi i këtij kursi është hartimi dhe përpunimi i grafikëve raster dhe vector përmes programeve kryesore të Adobe Photoshop dhe Illustrator, si dhe hartimi dhe botimi i materialeve komerciale për shtyp duke përdorur Adobe InDesign.

- **Web publikimi**

Madje edhe zhvillimi i një ueb faqeje të thjeshtë në përputhje me standardet aktuale kërkon njohuri të gjuhës së Hypertext Markup (XHTML) dhe Cascading Style Sheets (CSS). Shumë ueb faqe përdorin imazhe qoftë në formë të banerëve, butonave, logove, fotografive apo skenimeve. Adobe Fireworks është ndërtuar si një mjet për të krijuar dhe manipuluar imazhet nga ueb-i dhe për t'u mundësuar krijuesve që t'i përdorin këto imazhe për të zvogëluar madhësinë e fajllit. Firework gjithashtu ofron një integrim të shkëlqyer me Dreamweaver. Kjo seri ofron një hyrje të plotë në XHTML, CSS dhe krijimin e ueb grafikës.

- **Gjuha shqipe për qëllime profesionale**

Pas përfundimit të kursit gjuha shqipe për qëllime profesionale, studentët do të jenë në gjendje t'i përdorin praktikisht njohuritë e fituara që do t'u shërbejnë atyre për punësim dhe gjatë karrierës në të ardhmen. Nga studentët pritet ta

dallojnë gjuhën e folur dhe të shkruar, t'i dinë karakteristikat e komunikimit profesional (raport, CV, e-mail), specifikat e shkrimit formal, format më të zakonshme gramatikore, të bëjnë dallimin në mes stilit të të shkruarit shkencor, administrativ dhe socio-politik. Studentët do t'i mësojnë rregullat se si të organizojnë intervista dhe debate, do të dinë se si të shkruajnë një letër motivimi dhe të interpretojnë tekste të veçanta në formë të shkruar dhe të folur.

- **Te shkruarit akademik në gjuhën angleze**

Qëllimi i këtij kursi është t'u ndihmojë studentëve t'i zhvillojnë shkathtësitë akademike për të shkruar në mënyra të ndryshme. Studentëve do t'u mundësohet t'i komunikojnë idetë e tyre në mënyrë të qartë, rrjedhshëm dhe efektivisht që të prodhojnë një vepër të shkruar. Shkathtësitë akademike të studentëve do të zhvillohen gradualisht përmes ushtrimeve që ndihmojnë gjatë të shkruarit si: shkrimi i llojeve të ndryshme të paragrafëve dhe eseeve. Gjithashtu, studentët do të njoftohen me rregullat e citimit dhe parafrazimit dhe do ta kuptojnë se çka është plagjiatura. Informata kthyesë e një vepre të shkruar do të përfshijë përmirësimin e gabimeve nga vetë studentët, përmirësimin e gabimeve ndërmjet studentëve dhe përmirësimin e gabimeve të mësimdhënësit në përmbajtje, organizim dhe të gabimeve gjuhësore.

- **Të shkruarit akademik në gjuhën maqedonase**

Pas mbarimit të shkrimit akademik të gjuhës maqedonase, nga studentët pritet që të arrijnë njohuri të përkatëse dhe komunikim të avancuar në gjuhën maqedonase me theks të veçantë në shkathtësitë e të shkruarit. Pos kësaj, pritet që studentët të bëhen më autonomë në mësimin e gjuhës dhe të marrin përgjegjësi për mësimin e tyre. Pas mbarimit të shkrimit akademik të gjuhës maqedonase, studentët do të jenë në gjendje t'i plotësojnë aftësitë e tyre të shkrimit në shumë nivele dhe në këtë mënyrë të bëhen më të sigurt dhe më kompetentë gjatë të shkruarit në gjuhën maqedonase. Studentët do të kenë mundësi që në mënyrë kritike të reflektojnë mbi tema të ndryshme dhe të japin konkludime dhe do të fitojnë aftësi për shkrim dhe komunikim të shkëlqyer në gjuhën maqedonase.

- **Gjuha gjermane (niveli 1-4)**

Pas përfundimit të çdo niveli nga studentët pritet që të kenë fituar njohuri të duhura në përputhje me Kornizën evropiane të gjuhëve (të përcaktuara saktësisht në nivele). Përveç kësaj pritet që studentët të bëhen më të pavarur dhe më të përgjegjshëm ndaj mësimin të gjuhës. Deri në fund të kursit studentët do të jenë në gjendje që në mënyrë kritike të reflektojnë mbi tema të ndryshme dhe të japin konkludime. Studentët, gjithashtu, do të jenë në gjendje t'i shprehin mendimet dhe opinionet e tyre në formë të shkruar dhe gojarisht në gjuhën gjermane.

- **Mbrojta e ambientit**

Qëllimet e këtij kursi janë: T'i njoftojë studentët me problemet kryesore të mjedisit; T'i njoftojë studentët me rolin e njeriut si faktor kyç në procesin e ndotjes dhe mbrojtjes së ambientit; T'i njoftojë studentët me ndikimin e ndotësve të ndryshëm të ambientit në shëndetin e njeriut, veprimtarinë profesionale dhe aftësitë organizuese të faktorit njerëzor; Krijimi i shprehive pozitive ndaj ambientit dhe ngritja e vetëdijes për një mjedis më të shëndetshëm dhe më të pastër; Legjislacioni ndërkombëtar dhe kombëtar dhe konventat ndërkombëtare mbi mjedisin; Hyrje në politikat globale kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e mjedisit; Mjedi si një kusht për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik; Roli i shoqërisë në mbrojtjen e mjedisit; T'i njoftojë me rreziqet kryesore për një mjedis të shëndetshëm; T'i njoftojë me Strategjinë kombëtare të mjedisit në Republikën e Maqedonisë.

- **Zhvillimi profesional i karrierës**

Kjo lëndë ofron praktikë dhe rezultate të orientuara kah kërkimi, fitimi dhe mbajtja e punës. Ka për qëllim që studentëve t'u sigurojë shkathtësi përkatëse për nevojat e vendeve moderne të punës. Detyrë specifike do ta kenë përpilimin efektiv të CV-së, shkrimi i letrës së interesit/kërkesës, shkathtësi për të intervistuar, komunikim zyrtar në zyrë (memorandume, e-maile zyrtare për mbikëqyrësit, konsumatorët, raporte e të tjerë). Elemente shtesë që do të përfshihen në këtë lëndë janë: si të zbatohet vetevaluimi, qeverisja e konflikteve interzyrtare dhe si të kërkohen aktivisht promovimet. Aftësitë e fituara në këtë lëndë do të jenë të zbatueshme edhe në procesin e kërkimit të punës në përgjithësi.

- **Debat dhe shkathtësi prezantimi**

Qëllimi i lëndës është që studentët të fitojnë aftësitë për diskutim dhe argumentim efektiv, si dhe të zhvillojnë besim para publikut.

- **Të shkruarit akademik në gjuhën shqipe**

Qëllimi i lëndës është që të zhvillojë aftësitë akademike tek studentët për shkrim në mënyra të ndryshme. Studentëve do t'u mundësohet t'i vënë në dukje idetë e tyre qartë, rrjedhshëm dhe në mënyrë efektive për të krijuar një tekst të shkruar. Shkathtësitë akademike të studentëve do të zhvillohen gradualisht përmes ushtrimeve që ndihmojnë në të shkruarit, si: paragrafë të ndryshëm dhe ese. Gjithashtu, studentët do të njihen me rregullat e citimit, parafrazimit, si dhe do të kuptojnë se çfarë do të thotë plagjiaturë.

- **Sportet, rekreacioni, kultura**

Mësimi teorik: Në përgjithësi mbi sportet, disiplinat, higjienën, mjekësinë e sportit, të ushqyerit dhe kulturën e përgjithshme. Mësimi praktik: organizimi i lojërave sportive individuale dhe kolektive dhe aktiviteteve tjera në sallë dhe në objektet tjera sportive në kampus.